

Gjyqtar Sokol Çomo

Z. Çomo kryen detyrën e anëtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese, që prej datës 17.06.2017.

Gjyqtari Sokol Çomo ka lindur në vitin 1972 dhe ka përfunduar studimet e larta universitare në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 1994. Fillimisht, ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga kjo detyrë është shkëputur për një periudhë të shkurtër kohore për të ushtruar funksionin e zëvendësministrit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Më pas, është rikthyer pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të ushtruar funksione, si: gjyqtar, zëvendëskryetar dhe kryetar i kësaj gjykate. Për një periudhë, ai ka ushtruar edhe veprimtarinë e avokatit. Z. Çomo ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe detyra të tjera të lidhura me administrimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor.

Prej shumë vitesh, është pedagog i jashtëm pranë Shkollës së Magjistraturës për lëndën “E drejta e Procedurës Civile”.